



REPUBLIKA E SHQIPERISE
BASHKIA BERAT
DREJTORIA JURIDIKE

Nr. _____ prot.

Berat, më ____/____/2026

PROCES VERBAL - Tipi i kontratës - PUNË

**PËR ARGUMENTIMIN DHE MIRATIMIN E SPECIFIKIMEVE TEKNIKE DHE
KRITEREVE PËR KUALIFIKIM**

OBJEKTI I PROKURIMIT : MBROJTJA NGA GËRRYERJA E LUMIT OSUM, RRUGA BY-PASS, PRANË URËS SË BILÇËS

KODI PÛRKATËS NË FJALORIN E PËRBASHKËT TË PROKURIMIT (CPV) : **45000000-7__pune ndertimi**

VLERA E FONDIT LIMIT : **37 481 005.86** (Tridhjetë e shtatë milion e katërqindë e tetëdhjetë e një mijë e pesë presje tetëdhjetë e gjashtë) Lekë pa Tvsh.

Në bazë të nenit 21, pika 2, të Ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”, nenit 2, pika 2/c dhe nenit 78, pika 2, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, autoriteti/enti kontraktor Bashkia Berat ka hartuar proces verbalin për argumentimin dhe miratimin e specifikimeve teknike dhe kriterëve për kualifikim për procedurën e sipërcituar, me përmbajtjen si më poshtë :

KRITERET E VEÇANTA TË KUALIFIKIMIT

1. Kandidati/ofertuesi duhet të dorëzojë :

- a. Sigurimin e Ofertës, sipas Shtojcës 3;
- b. Formulari përmbledhës i vetdeklarimit, sipas Shtojcës 8;

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme bazohen në nenet 76, 82 dhe 83 të LPP, dhe nenin 26, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2. Kandidati/Ofertuesi duhet të dorëzojë :

2.1. Përshtatshmëria për të kryer veprimtarinë profesionale (nëse është e aplikueshme) :

Sipas përcaktimeve të bëra në Shtojcën 7 të DST-ve (Kriteret e Përgjithshme të Përzgjedhjes/Kualifikimit).

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme bazohet në nenin 77, pika 1/a dhe 2, të LPP, nenin 39, pika 6/b, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

2.2. Kapaciteti ekonomik dhe financiar :

2.2.1 Për të provuar kapacitetet ekonomike dhe financiare, operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetim për xhiron vjetore për tre vitet e fundit financiare ku vlera e xhiros për të paktën një nga vitet e periudhës së kërkuar duhet të jetë jo më e vogël se vlera e parashikuar e kontratës që po prokurohet.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në vlerën e fondit limit të kësaj procedure, si dhe bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i vlerës së kërkuar argumentohet si më poshtë :

Vendosja e këtij kriteri kualifikues i shërben Autoritetit Kontraktor për të vërtetuar se operatori ekonomik fitues i zotëron të gjitha kapacitetet ekonomike dhe financiare për të përmbushur me sukses kontratën.

2.2.2 Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin bilancet vjetore, për tre vitet e fundit financiare të paraqitura në organet tatimore dhe të konfirmuara nga ana e këtyre organeve. Kërkesa konsiderohet e përmbushur nëse bilancet janë në përputhje me parashikimet e nenit 43/4 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 të ndryshuar.

Kur oferta paraqitet nga një bashkim operatorësh, ky kusht, plotësohet nga secili anëtar i bashkimit në raport me përqindjen që ka në këtë bashkim operatorësh.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 3, e LPP, si dhe nenin 43, pika 4, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”.

Përcaktimi i viteve të kërkuara për paraqitjen e bilanceve është bërë duke iu referuar legjislacionit të fushës, konkretisht, ligjit nr. 8438 datë 28.12.1998 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, Udhëzimit të Ministrit të Financave nr. 5 datë 30.01.2006 “Për tatimin mbi të ardhurat”, i ndryshuar, si dhe kërkesave të ligjit Nr. 25/2018 “Për kontabilitetin dhe pasqyrat financiare. Ndërsa shoqërimi me Akt Ekspertizën e Ekspertit Kontabël të Autorizuar, bëhet duke iu referuar parashikimit në nenin 41 shkronja c” të Ligjit nr. 1009/2009 “*Personat juridikë që detyrohen për auditimin ligjor të pasqyrave financiare detyrohen të kryejnë auditimin ligjor të pasqyrave financiare vjetore, përpara publikimit të tyre, nga ekspertë kontabël ose shoqëri audituese. “c) shoqëritë me përgjegjësi të kufizuar, të cilat zbatojnë për raportimin financiar standardet kombëtare të kontabilitetit, kur në mbyllje të periudhës kontabël, për dy vite radhazi, tejkalojnë **dy prej tre treguesve të mëposhtëm : i) totali i aktiveve të bilancit në mbyllje të periudhës kontabël përkatëse, arrin ose e kalon shumën prej 50 milionë lekësh, ii) shuma e të ardhurave nga veprimtaria ekonomike (qarkullimi) në atë periudhë kontabël arrin ose e kalon shumën prej 100 milionë lekësh, iii) ka mesatarisht 30 të punësuar gjatë periudhës kontabël***”.

2.2.3. Operatorët ekonomikë duhet të paraqesin vërtetime që dëshmojnë se kanë paguar detyrimet përkatëse, të taksave dhe tarifave vendore, në përputhje me përcaktimet e ligjit nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për sistemin e taksave vendore”, i ndryshuar, në të gjitha vendet ku kanë ushtruar aktivitet sipas të dhënave të QKB-së, për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026.

Në rastet e bashkimit të operatorëve ekonomik çdo anëtar i grupit të BOE duhet të dorëzojë vërtetimin lëshuar nga Njësitë Administrative përkatëse ku ka ushtruar apo ushtron aktivitet për vitin 2025 dhe detyrimet e maturuara për vitin 2026, sipas të dhënave të QKB-së.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar sipas Nenit 76 të Ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Kreut V, Seksioni III, Neni 43, pika 6 të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” si dhe sipas Ligjit Nr. 9632 datë 30.10.2006 “Për Sistemin e Taksave Vendore” (i ndryshuar).

2.3. Aftësitë teknike dhe profesionale :

2.3.1. Përvojë të sukseshme në realizimin e të paktën :

- a. punë të ngjashme për një objekt të vetëm në një vlerë jo më të vogël se 50% e vlerës së përlogaritur të kontratës që prokurohet (pa TVSH) dhe që është realizuar gjatë pesë viteve të fundit, nga data e shpalljes së njoftimit të kontratës.

ose

- b. punë të ngjashme deri në një kufi, ku vlera monetare totale e punëve të kryera, e marrë së bashku gjatë pesë viteve të fundit, është jo më e vogël se dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet (pa TVSH).

Plotësimi i njërit prej dy kushteve të sipërpërmendura e ben oferten të kualifikueshme.

Vlerësimi i përvojës së suksesshme të Operatorit/ve Ekonomik do të kryhet bazuar në dokumentat e mëposhtme:

i) Për kontrata të realizuara me ente publike, operatori/et ekonomik, duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm, ku të shënohen vlera, afati i përfundimit të kontratës dhe natyra e punës së bërë, për të vërtetuar përmbushjen e suksesshme të punëve:

1. Formular vlerësimi për realizimin e punimeve sipas shtojcës nr.9, shoqëruar me;
2. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
3. Situacionin përfundimtar të objektit;

Formulari i vlerësimit duhet të përcaktojë saktësisht cilësinë e kryerjes së punëve, faktin nëse kontrata është realizuar me sukses, përqindjen e punimeve në rast bashkimi të shoqërive, etj.

ii) Për kontrata të realizuara me sektorin privat, operatori/et ekonomik duhet të paraqes/in dokumentacionin e mëposhtëm:

1. Kontratën/at e Sipërmarrjes;
2. Situacionin përfundimtar të objektit;
3. Fatura tatimore të deklaruara në organet tatimore .

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, pika 4, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 5, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”. Me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën, prandaj është kërkuar që punët e mëparshme të ngjashme të jenë minimalisht në vlerat 50 % të vlerës së fondit limit, për një objekt të vetëm, ose dyfishi i vlerës limit të kontratës që prokurohet, për punët totale të ngjashme të kryera në 5 vitet e fundit, që janë brenda vlerave kufi të përcaktuara në nenin e sipërcituar.

2.3.2. Liçensa profesionale lidhur me ekzekutimin e punëve të kontratës

2.3.2/a Operatorët ekonomik duhet të paraqesin licencën profesionale të shoqërisë, të vlefshme për zbatimin e punimeve objekt kontrate, të lëshuar nga Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, në bazë të VKM nr. 42 datë 16.01.2008 të ndryshuar, e cila përfshin kategoritë e mëposhteme :

Për punimet e përgjithshme të ndërtimit :

NP - 1 A Punime gërmimi në tokë

NP - 9 B Punime dhe mbrojtje lumore sisteme hidraulike dhe bonifikime

Për punimet speciale të ndërtimit :

NS - 8 A Ndërtime parafabrikat beton të armuar, struktura metalike dhe druri

NS - 18 A Punime topogjeodezike

Për operatorët e huaj të bëhet njëhësimi i liçencës profesionale që disponojnë nga vendi i origjinës pranë Institucionit përkatës, në plotësim të liçencave profesionale të kërkuara për ekzekutimin e kontratës.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 77, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 42 datë 16.01.2008 “Për miratimin e rregullores për kriteret dhe Procedurat e dhënies së liçensave profesionale të zbatimit, klasifikimit dhe disiplinimit të subjekteve juridike që ushtrojnë veprimtari ndërtimi”, i ndryshuar.

Kategoritë e kërkuara janë kërkuar bazuar në zërat dhe vlerat e punimeve, sipas preventivit bashkëngjitur në SPE.

Kategoria	Përshkrimi i	Zërat e punimeve që	Niveli i klasifikimit	Vlera e
-----------	--------------	---------------------	-----------------------	---------

e kërkuar	kategorisë sipas legjislacionit të fushës	parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse	i kërkuar për kategorinë respektive	punimeve që parashikohen të kryhen në preventiv, që përfshihen në kategorinë përkatëse
NP - 1	Punime gjërmimi në tokë	Në këtë kategori Përfshihet zëri i Gjërmim dhe me ekskavator goma, 0.25 m ³ në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në tokë dhe zëri 10 - Gjërmim dhe me ekskavator zinxhir 0.25 m ³ , në kanale gjerësi > 2 m, prani uji - 2 m, kategoria III, me shk në tokë	A (0-20 milionë lekë)	Brenda v1erës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NP - 9	Punime dhe mbrojtje lumore sistemime hidraulike dhe bonifikime	Në këtë kategori përfshihen zërat 4 - Gabiona me rrjetë teli të zinguar e gurë kave lxl m, 5 - Gabiona me rrjetë teli të zinguar, gurë kave 1x1x1.5 m etj.	B (21-50 milionë lekë)	Brenda v1erës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NS - 8	Ndërtime parafabrikat beton të armuar, struktura metalike dhe druri	Kjo kategori licence i referohet zërave të punimeve të parashikuara në preventin e punimeve, konkretisht në zërat 7, 8, 9	A (0-20 milionë lekë)	Brenda v1erës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar
NS - 18	Punime topogjeodezike	Lidhet me piketimin e objektit, kuotat për sistemimin e sheshit etj.	A (0-20 milionë lekë)	Brenda v1erës së kufirit të parashikuar në VKM Nr. 42 datë 16.01.2008 i ndryshuar

2.3.3. Dëshmi për fuqinë punëtore të operatorit ekonomik :

a) Operatorët ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojnë personelin kryesor, drejtues teknik në licencën e shoqërisë, si më poshtë :

- Inxhinier Ndërtimi 1 (një)
- Inxhinier Mekanik 1 (një)
- Inxhinier Hidroteknik 1 (një)

- Inxhinier Topograf/Gjeodet/Markshajder 1 (një)

Për këtë operatorët ekonomik duhet të paraqesin :

- Kontratë pune, Diplomën Universitare

Në çdo rast, Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të bëjë verifikime lidhur me deklarin e OE, në funksion të përmbushjes së këtij kriteri.

Shënim : Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e shkronjave a) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr.162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514 datë 20.9.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Ndërtimit** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve të objektit që prokurohet.
- **Inxhinieri Mekanik** është përgjegjës në këtë objekt, pasi zërat kryesorë të preventivit parashikojnë përdorimin intensiv të makinerive dhe pajisjeve mekanike, si: **Gërmime me ekskavator me goma dhe me zinxhir**, për realizimin e gërmimeve dhe kanalit të devijimit të lumit; **Transport të dherave me automjete**, që kërkon organizimin dhe monitorimin e flotës së mjeteve; **Vendosjen e gabioneve**, e cila realizohet me mjete ngritëse dhe makineri për transportin dhe pozicionimin e gurëve; **Hedhjen e betonit (C12/15)**, që kërkon përdorimin e autobetonierave, pompave të betonit dhe pajisjeve ndihmëse; **Montimin e tobinove dhe tubave HDPE**, ku nevojiten pajisje mekanike për ngritje, vendosje dhe pozicionim me saktësi.
- **Inxhinieri Hidroteknik** është përgjegjës për zbatimin e saktë të punimeve hidroteknike lidhur me zërat e punimeve të parashikuara në preventiv.
- **Inxhinieri Topograf/Gjeodet/Markshajder** është përgjegjës për zbatimin e saktë të kuotave të projektit objekt prokurimi për realizimin e saktë të kuotave të themeleve, kuotave të shtresave etj.

2.3.3.1. Operatori ekonomik për realizimin e punimeve objekt kontrate, duhet të disponojë edhe stafin mbështetës (jo domosdoshmërisht drejtues teknik në licencën e shoqërisë), si më poshtë :

- Inxhinier Mjedisi 1 (një)
- Inxhinier Gjeoteknik 1 (një)

Argumentimi : Kërkesat e pikës 2.3.3.1, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika

6/e), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Inxhinieri i Mjedisit** është përgjegjës për zbatimin e zërave të preventivit për punime gjurmimi, heqje dherash etj, që kanë ndikim negativ në mjedisin përreth.
- **Inxhinieri Gjeoteknik** është përgjegjës për analizimin e formacioneve të tokës, ku do të ndërtohen gabionat.

2.3.3/a Operatorët ekonomik duhet të përcaktojnë me anë të një deklarate nga (Administratori i shoqërisë), Drejtuesin Teknik të Kantierit, i cili do të sigurojë drejtimin teknik të punimeve në kantier dhe nuk duhet të jetë i angazhuar në kontrata të tjera. Përgjegjësi Teknik i Kantierit, i deklaruar duhet të plotësojë kriteret e përcaktuara në Udhëzimin nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”

Argumentimi për drejtuesin teknik : Së pari kjo kërkesë mbështetet në Ligjin Nr. 162 datë 23.12.2020 “Për Prokurimin Publik”, Neni 77, pika 4, si dhe në VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik” i ndryshuar, Kreu V, Seksioni III, Neni 39, pika 6, gërma “c”.

Së dyti duke qenë se objekti prokurimit është kontratë pune sqarojmë se detyrimin për prezencën e Drejtuesit Teknik gjatë gjithë kohës që do të kryhen punimet në objekt e përcakton qartazi Udhëzimi Nr. 2 datë 13.05.2005 “Për zbatimin e punimeve të ndërtimit”, konkretisht pika 1.2 ku citohet se “drejtuesit ligjor dhe teknik të sipërmarrësit janë përgjegjës përpara investitorit për ndërtimin e veprës, sipas projektit, për kryerjen e punimeve të ndërtimit, në përputhje me kushtet teknike të zbatimit, specifikimet teknike, sigurimin teknik dhe mbrojtjen në punë, brenda kushteve të kontratës e dispozitave ligjore në fuqi” si dhe pikës 2.1 ku citohet se “drejtimi teknik i punimeve në kantier sigurohet sipas rastit, drejtpërdrejtë nga drejtuesi teknik i sipërmarrësit ose përgjegjësi teknik i kantierit”.

2.3.3/b Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se kanë të punësuar në stafin e tyre 1 (një) punonjës i cili të plotësojë kërkesat dhe të disponojë çertifikatën si **“Përgjegjës për sigurinë dhe mbrojtjes e shëndetit në punë”**, në përputhje me klauzolat e Ligjit Nr. 10237 datë 18.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM Nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”.

Për këtë operatorët ekonomik duhet të paraqesin :

- kontratën e punës,
- diplomën/certifikatën përkatëse.

Shënim : Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesa e shkronjës d) të pikës 2.3.3, të kriterëve të veçanta për kualifikim, është bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht :

Kërkesa e mësipërme mbështetet në ligjin nr. 10327 datë 15.02.2010 “Për sigurinë dhe shëndetin në punë” dhe VKM nr. 312 datë 05.05.2010 “Për miratimin e rregullores “Për sigurinë në kantier”. Natyra e kontratës dhe specifikat e saj kërkojnë njohuri e përgatitje të posaçme për vlerësime të përpikta për të zgjidhur çështje që lidhen me garantimin e sigurisë dhe mbrojtjen në punë. Në rregulloren për sigurinë në kantier miratuar me VKM nr. 312/2010 është përcaktuar se punëdhënësi për mbrojtjen dhe parandalimin nga rreziqet, duhet të ofrojë kurse formimi përkatës në fushën e sigurisë e të shëndetit në vendin e punës. Çdo punëdhënësi zgjedh një ose disa persona si përgjegjës për ndihmën e parë në rast emergjencash dhe për sigurinë e mbrojtjen e shëndetit. Rregullorja përcakton kërkesat minimale të sigurisë dhe të shëndetit në punë për kantieret e përkohshëm ose të lëvizshëm, si dhe masat e përgjithshme të mbikëqyrjes.

2.3.4. Operatorët ekonomik duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar, si më poshtë :

- | | |
|--------------------------------|-------------|
| - Teknik Ndërtimi | 1 (një) |
| - Teknik topograf | 1 (një) |
| - Murator | 4 (katër) |
| - Betonues | 1 (një) |
| - Karpentier | 2 (dy) |
| - Hekurkthyes | 1 (një) |
| - Mekanik | 1 (një) |
| - Punëtor të thjeshtë ndërtimi | 6 (gjashtë) |

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- Certifikata/diploma për formimin profesional (të vlefshme), të cilat duhet të jenë të lëshuara nga institucione publike/private të licensuara sipas ligjit Nr. 15/2017 “Për arsimin dhe formimin profesional në R.Sh.”, i ndryshuar.
- Të figurojnë në listëpagesa minimalisht për periudhën e muajit të fundit.

Diplomat/certifikatat e paraqitura nga organizma të cilat nuk janë të licencuara sipas legjislacionit në fuqi do të konsiderohen si dokumenta të rreme të cilat përbëjnë shkak për skualifikim.

Shënim : Kjo kërkesë përmbushet nëpërmjet plotësimit dhe paraqitjes nga operatorët ekonomikë të formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, sipas shtojcës 8 të DST.

Dokumentacioni provues do të paraqitet nga ofertuesi i kualifikuar në vend të parë, pranë autoritetit kontraktor, përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, ose nëse do të jetë nevoja për të kërkuar sqarime nga AK.

Argumentimi : Kërkesat e pikës 2.3.4, të kriterëve të veçanta për kualifikim, janë bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 39, pika 6/c), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, të ndryshuar dhe VKM nr. 514 datë 20.09.2017 “Për miratimin e listës kombëtare të profesioneve (LKP)”, të rishikuar, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës.

Personeli i mësipërm kërkohet në bazë të vlerësimit të preventivit dhe të grafikut të punimeve.

- **Tekniku i ndërtimit** është i nevojshëm për ndjekjen e realizimit të punimeve të ndërtimit, sipas zërave të preventivit të punimeve.
- **Teknik topograf** është i nevojshëm për zbatimin me përpikmëri vendosjen e kuotave, nën mbikëqyrjen e inxhinierëve.
- **Murator** janë të nevojshëm për realizimin e gabionave, sipas zërave të preventivit të punimeve, nën mbikëqyrjen e inxhinierit. Numri prej katër punëtorësh është përcaktuar në bazë të zërave të punimeve dhe nr. të nevojshëm për zbatimin e tyre.
- **Betonues** është i nevojshëm për realizimin e punimeve të betonit, sipas zërave të preventivit të punimeve, nën mbikëqyrjen e inxhinierit.
- **Karpentierët** janë të nevojshëm për ndërtimin e kornizave dhe strukturave përforcuese prej druri të cilat do shërbejnë për betonimin, nën mbikëqyrjen e inxhinierit. Numri prej dy punëtorësh është përcaktuar në bazë të volumit të zërave në preventiv.
- **Hekurkthyesit** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të hekurit për formimin e koshave të gabionave sipas përmasave të dhëna në projekt-preventiv, referuar zërave të preventivit të punimeve, nën mbikëqyrjen e inxhinierit.
- **Mekaniku** është i nevojshëm për të shmangur vonesat në rast të difekteve që mund të ndodhin mjeteve.
- **Punëtor të thjeshtë ndërtimi** janë të nevojshëm për realizimin e punimeve të ndryshme sipas zërave të preventivit, nën mbikëqyrjen e inxhinierit. Numri prej gjashtë punëtorësh është përcaktuar në bazë të zërave të punimeve dhe nr. të nevojshëm për zbatimin e tyre dhe afatit të realizimit të punimeve.

2.3.4.1 Operatorët ekonomik duhet të disponojnë punonjës të specializuar/të kualifikuar për kryerjen e punimeve, si më poshtë :

- | | |
|------------------|----------|
| - Eskavatorist | 2 (dy) |
| - Automakinist | 2 (dy) |
| - Buldozerist | 2 (dy) |
| - Shofer kamioni | 5 (pesë) |

Për punonjësit e mësipërm duhet të paraqiten :

- Kontratat e punës individuale të vlefshme.
- (Dëshmi të Aftësisë Profesionale), që të vërtetojë kualifikimin profesional të kërkuar, referuar rregullores “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe tokë, si dhe disiplinimi i përdorimit të

tyre”, miratuar me urdhërin Nr. 200 datë 16.05.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës dhe referuar Kodit Rrugor, e cila duhet të përkohet me kërkesat e profilin të deklaruar për çdo punonjës.

- Gjatë fazës së ofertimit në plotësimin e formularit përmbledhës të vetëdeklarimit, pika B. Deklarata - “Për disponimin e punonjësve të nevojshëm për realizimin e punimeve objekt kontrate”, operatorët ekonomik për punonjësit eskavatoristë/manovrator, automakinist, shofer, duhet të deklarojnë : emër/mbiemër, profilin e punës, numrin e dëshmisë së aftësisë profesionale dhe datën e vlefshmërisë së saj.

Kur mjetet janë marrë me qira nga persona fizik, të cilat janë në pronësi të këtyre të fundit, atëherë eskavatorist / buldozeristët, automakinistët, dhe shoferët nuk ka nevojë që të figurojnë në listëpagesat përkatëse të O.E ofertues.

Në rastin e bashkimit të operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë punonjësit e mësipërm, në përputhje me përqindjen dhe/ose natyrën e pjesëmarrjes në punë, shërbim apo furnizim, të përcaktuara në aktmarrëveshje.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në pikën 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm të kualifikuar për realizimin me sukses të kontratës, si dhe bazuar në rregulloren “Për kushtet, kriteret dhe programet për përgatitjen teoriko-praktike të kandidatëve, si dhe dhënien e Dëshmisë së Aftësisë Profesionale për përdoruesit e makinerive të rënda për punime ndërtim dhe toke, si dhe disiplinimi i përdorimit të tyre”, miratuar me urdhërin nr. 200 datë 16.05.2019, të Ministrit të Infrastrukturës dhe Energjitikës.

2.3.5. Operatori ekonomik duhet të ketë një punësim jo më pak se **35 (tridhjetë e pesë)** punonjës të cilët duhet të figurojnë në listëpagesat e shoqërisë minimumi muajin e fundit të deklaruar nga data e hapjes së ofertave e vërtetuar me :

- Vërtetim të lëshuar nga Administrata Tatimore për periudhën e muajit të fundit të deklaruar.
- Listëpagesat e punonjësve të konfirmuara nga autoritetet përkatëse sipas formatit që kërkohet nga legjislacioni në fuqi për periudhën e muajit të fundit të deklaruar.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me vetëdeklarimin sipas Formularit Përmbledhës të Vetëdeklarimit, sipas shtojcës Nr. 8, të DST-ve dhe në zbatim të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 “Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, neni 26 “Formulari Përmbledhës i Vetëdeklarimit”, pika 6 “Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar, i pari dorëzimin e dokumenteve provuese”.

Kriteri konsiderohet i përmbushur me paraqitjen e formularit të vetëdeklarimit sipas Shtojcës 8.

Shënim : Përpara publikimit të njoftimit të fituesit dhe nisjes së afateve të ankimit, autoriteti/enti kontraktor i kërkon ofertuesit të kualifikuar i pari dorëzimin e dokumentacionit të lartë përmendur shoqëruar.

Argumentimi : Në bazë të pikës 4, të nenit 77, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik” dhe nenit 39, pika 6/c, ç), të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”, me anë të këtij kriteri kërkohet që operatorët ekonomikë të dëshmojnë që kanë personelin e nevojshëm për realizimin me sukses të kontratës. Konkretisht : Vendosija e këtij kriteri për fuqinë punëtore është bërë në përputhje me zërat dhe volumet e preventivit, me afatin e zbatimit të punimeve sipas grafikut të punimeve.

Nr.	Nr. Analizës	Përshkrimi i punimeve	Njësia	Sasia	O.p / njësi	Totali i orëve të punës
		Punime për ndërtim mur gabioni				
1	3.87/b	Gërmim dheu me ekskavator goma, 0.25 m3, në kanale gjerësi > 2 m, toke zak, kategoria III, me shk në tokë	m3	1040	0.11	114.4
2	3.396	Mbushje me cakëll pas mureve	m3	900	0.38	342
3	3.158/5a	Transport dheu me auto deri 5.0 km	m3	1040	0.25	260
4	3.331	Gabiona me rrjetë teli të zinguar e gurë kave 1x1x1 m	m3	1414	5.6	7918.4
5	3.332	Gabiona me rrjetë teli të zinguar, gurë kave 1x1x1.5 m	m3	1944	5.3	10303.2
6	3.643/c	F.V Dhe humusorë	m3	50	0.28	14
7	3.240	Struktura monolite betoni C 12/15 mbi gabione	m3	80	14.3	1144
8	3.369	Tombino me tuba betoni Ø1500, mbi shtresë betoni	m3	45	16.33	734.85
9	3.24	Beton C 12/15 për blloqe betoni për rigjidimin e rreshtave me gabiona	m3	340	14.3	4862
10	3.164/1t	F.V Tuba të brinjëzuar HOPE SN8 d=315 mm	ml	60	1.5	90
		Totali i orëve të punës				25903
		Totali i ditëve të punës (Totali i orëve të punës/8 orë)				3237.856
		Ditë pune gjithësej (Afati 6 muaj x 22 ditë pune/muaj)				132
		Numri i punonjësve (Manovrator + shofer + punonjës të kualifikuar + puntorë)				25
		Stafi drejtues (inxhiniera + teknik ndërtimi + teknik topograf + Përgjegjës për sigurinë + ekspert për ndihmën e parë dhe ndërhyrjen ndaj emergjencave + eksperti zjarrfikës + roje)				10
		Numri total i punëtorëve				35

Dëshmia e kërkuar për numrin e fuqisë punëtore të operatorit ekonomik e nevojshme për ekzekutimin e objektit të kontratës, është dokument që vërteton kapacitetin teknik dhe profesional të operatorit, për sa kohë janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Deklarimi dhe regjistrimi i punonjësve në regjistrin e sigurimeve është një detyrim ligjor i punëdhënësit e parashikuar nga Kodi i Punës, për rrjedhojë vërtetimi i lëshuar nga administra tatimore e shoqëruar me listëpagesat me këtë kohështirje është dokument vërtetues për qëndrueshmërinë e të punësuarve, përvojën e tyre, dhe janë në përpjesëtim me natyrën dhe përmasat e kontratës. Nr i punonjësve që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 date 10.09.1998 “Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit”, i ndryshuar dhe akteve nënligjore në zbatim të tij”.

2.3.6. Operatori ekonomik pjesëmarrës, për realizimin e kontratës, duhet të disponojë, mjetet dhe pajisjet e mëposhtme :

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Gjendja
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës 10 - 18 ton	3 copë	Në pronësi ose me qera
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Në pronësi ose me qera
3	Buldozier	1 copë	Në pronësi ose me qera
4	Dumper	2 copë	Në pronësi ose me qera
5	Eskavator me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
6	Eskavator me zinxhirë	1 copë	Në pronësi ose me qera
7	Fadromë me goma	1 copë	Në pronësi ose me qera
8	Eskavator me zinxhir me krah jo më pak se 20 m	1 copë	Në pronësi ose me qera
9	Autobetoniere (kantieri) me kap. mbajtës deri 2.5 m ³	2 copë	Në pronësi ose me qera
10	Autovinc me kapacitet ngrites min. 15 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
11	Autobot uji	1 copë	Në pronësi ose me qera
12	Rrul me peshë min 15 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera
13	Rrul me peshë 7 - 10 ton	1 copë	Në pronësi ose me qera

- a. Për mjetet në pronësi duhet të paraqitet : a) dokumenti që vërteton regjistrimin e mjetit : (akti i pronësisë); b) leje qarkullimi; c) çertifikatë e kontrollit teknik (e vlefshme); d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) çertifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).

- b. Për mjetet e deklaruar me qera duhet të paraqitet : a) kontrata përkatëse noteriale e qerasë e cila duhet të jetë e vlefshme për të gjithë periudhën e realizimit të kontratës, objekt i këtij prokurimi, b) dokumenti që verteton regjistrimin e tij (akti i pronësisë), c) leje qarkullimi; ç) certifikatën e kontrollit teknik (e vlefshme), d) siguracion mjeti (i vlefshëm); e) certifikatë për transport mallrash brenda vendit (e vlefshme).
- Operatori ekonomik duhet të deklarojë vendndodhjen e mjeteve në pronësi ose me qera me anë të një deklarate të firmosur dhe vulosur nga Administratori, me qëllim të verifikimit nga Autoriteti Kontraktor.

Shënim : Autoriteti Kontraktor rezervon të drejtën e verifikimit të saktësisë së informacionit. Mos dorëzimi i informacionit të saktë apo të rremë do të konsiderohet kusht për skualifikim dhe/ose fillim i hetimit administrativ për përjashtim të Operatorit Ekonomik nga procedurat e prokurimit.

Argumentimi : Kërkesat e mësipërme janë vendosur sipas pikës 4, të Nenit 77, të Ligjit Nr. 162 datë 23.12.2020 "Për Prokurimin Publik" dhe Nenit 39, pika 6, gërma"d" të VKM Nr. 285 datë 19.05.2021 "Për miratimin e rregullave të prokurimit publik", me anë të këtij kriteri kërkohet që Operatorët ekonomik të dëshmojnë që kanë mjetet e pajisjet teknike, të nevojshme për ekzekutimin e objektit të prokurimit, që ka në dispozicion apo që mund t'i vihen në dispozicion operatorit ekonomik për të përmbushur kontratën.

Makineritë janë përcaktuar në raport me punimet e parashikuara në preventiv dhe volumet e tyre, numrin e punëtorisë dhe kohëzgjatjen e ekzekutimit të kontratës.

Argumentimi për dokumentacionin e kërkuar për mjetet :

"Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 92 parashikon shprehimisht se "Automjetet, motomjetet dhe rimorkiot për të qarkulluar duhet të jenë të pajisura me një leje qarkullimi dhe të jenë të regjistruara pranë degëve përkatëse të Drejtorisë së Përgjithshme të Shërbimeve të Transportit Rrugor". "Kodi rrugor i Republikës së Shqipërisë" i ndryshuar, neni 79/3 parashikon shprehimisht se "Të gjitha mjetet që qarkullojnë dhe hyjnë në territorin e Republikës së shqipërisë, janë të detyruara të kalojnë në kontrollin teknik vjetor dhe atë periodik ". Ligji nr. 10076 datë 12.02.2009 "Për sigurimin e detyrueshëm në sektorin e transportit" neni 4 parashikon shprehimisht se : "Pronari i çdo mjeti transporti, përpara përdorimit të mjetit, është i detyruar të lidhë një kontratë sigurimi, sipas pikës 1 të nenit 2 të këtij" ligji, si dhe të sigurojë rinovimin e saj për aq kohë sa mjeti i transportit do të mbetet në qarkullim".

Autoriteti Kontraktor ka të drejtë të kryejë verifikimet e nevojshme mbi vërtetësinë e informacionit të deklaruar nga operatori ekonomik si më sipër, ose t'i kërkojë operatorit sqarime dhe dokumente mbështetëse për këto sqarime, në përputhje me nenin 26, pika 7, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021, "Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik"i ndryshuar.

Numri i mjeteve/makinerive që nevojiten për realizimin e kontratës është përcaktuar bazuar në ligjin Nr. 8402 datë 10.09.1998 "Për kontrollin dhe disiplinimin e punimeve të ndërtimit", i ndryshuar dhe akteve nënligjore.

Nr.	Mjete/pajisje teknike	Sasia	Punimet
1	Kamion vetëshkarkues me kapacitet mbajtës	3 copë	Nevojiten për

	10 - 18 ton		largimin e dherave që dalin nga procesi i gërmimit, për çakullin që hidhet pas mureve, gurët që nevojiten për gabionat.
2	Kamionçinë me kapacitet mbajtës deri në 3.5 ton	2 copë	Kamiocinat nevojiten për transportin e tubove, rrjetës së gabionave etj.
3	Buldozier	1 copë	Për shtytjen e materialeve të gjeneruara në shtratin e lumit.
4	Dumper	2 copë	Për lëvizjen brenda kantierit të gurëve, çakullit, inerteve për beton.
5	Eskavator me goma	1 copë	Për gërmimin e dheut sipas zërit nr.1 të preventivit.
6	Eskavator me zinxhirë	1 copë	Për punimet e gërmimit për devijimin e lumit, për ngarkim të dheut në kamiona, për mbushjen me çakull pas mureve.
7	Fadromë me goma	1 copë	Për fumizimin me gurë për procesin e ndërtimit të gabionave
8	Eskavator me zinxhir me krah jo më pak se 20 m	1 copë	Për punimet e gërmimit për devijimin e lumit.
9	Autobetoniere (kantieri) me kap. mbajtës deri 2.5 m3	2 copë	Për prodhimin e betonit.
10	Autovinc me kapacitet ngrites min. 15 ton	1 copë	Për ngritjen e tombinove.
11	Autobot uji	1 copë	Për trajtimin e betonit me ujë
12	Rrul me peshë min 15 ton	1 copë	Për ngjeshjen e gjurmës ku do ndërtohen gabionat.
13	Rrul me peshë 7 - 10 ton	1 copë	Për ngjeshjen e gjurmës ku do ndërtohen gabionat.

2.4. Kërkesa të tjera të veçanta për kualifikim :

2.4.1. Operatorët ekonomikë duhet të vërtetojnë se e zhvillojnë aktivitetin e tij në fushën objekt prokurimi në përputhje me standardet e menaxhimit të cilësisë, të shëndetit e sigurisë në punë dhe mjedisit. Për këtë duhet të paraqesin certifikatat e mëposhtme :

- Çertifikatën e menaxhimit të cilësisë ISO 9001:2015 (e vlefshme) ose ekuivalent, e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të mjedisit ISO 14001-2015 (e vlefshme) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të sigurisë dhe shëndetit ISO 45001-2018 / ISO 45001-2023, (e vlefshme) ose ekuivalent e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.
- Çertifikatën e menaxhimit të Sigurisë së Qarkullimit Rrugor ISO 39001-2012 (e vlefshme) ose ekuivalent , e akredituar nga DPA ose nga Organizma Ndërkombëtarë Akreditues, të njohur nga Republika e Shqipërisë.

Certifikatat duhet të jenë të vlefshme në kohën e zhvillimit të tenderit. Në rastet e Bashkimit të Operatorëve ekonomik, çdo anëtar i grupit duhet të paraqesë Çertifikatën ISO sipas zërave të punimeve që do të marrë përsipër të realizojë sipas akt marrëveshjes.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 79, të ligjit nr. 162 datë 23.12.2020 “Për prokurimin publik”, nenin 44, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik”.

ISO 9001:2015 është në seri normash dhe standartizimesh ndërkombëtare, që i referohen sistemeve të menaxhimit të cilësisë, pra, të strukturave të organizimit të ndërrmarjeve publike dhe private, struktura të cilat këto ndërrmarje duhet t'i adoptojnë për një orientim më të mirë të ndërrmarjes në standartet e tregut. AK gjykon se cdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 9001:2015 me qëllim efektivitetin dhe efektshmërinë në zhvillimin e veprimtarisë së tij, e cila do të sjellë dhe zvogelimin e kostove. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ofrojnë cilësi të mirë me cmime të ulta.

ISO 14001:2015 ofron në kuadër praktik për shoqëritë që duan të menaxhojnë rreziqet mjedisore ekzistuese dhe potenciale. Ky sistem integrohet lehtësisht në strukturën e menaxhimit të biznesit për të kontrolluar impaktet që aktivitetet, operacionet, produktet dhe shërbimet kanë mbi mjedisin. AK gjykon se cdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 14001:2015 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tij (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të identifikojë impaktin në mjedis gjatë aktivitetit të saj si dhe të përmirësojë performancën mjedisore duke zbatuar një qasje sistematike. Pra ky certifikim do të bëjë të mundur që Ofertuesit të ushtrojnë veprimtarinë duke pasur në konsideratë parimin e mbrojtjes së mjedisit.

ISO 45001-2018 është standard ndërkombëtar, i cili parashtrohet kërkesat për menaxhimin e praktikave të mira të sigurisë dhe shëndetit në punë për cdo organizatë, pavarësisht nga madhësia. AK gjykon se cdo Ofertues duhet të jetë i pajisur me ISO 45001-2018 me qëllim që veprimtaria e ushtruar nga ana e tyre (në rastin konkret realizimi i punës objekt prokurimi) të

realizohet duke u mbështetur mbi parimin e sigurisë dhe shëndetit në punë. Kjo kërkesë shërben dhe si një garanci extra që do të sjellë reduktimin e aksidenteve dhe sëmundjeve në vendin e punës duke minimizuar kostot si dhe kohën në përmbushjen me sukses të kontratës së punës objekt prokurimi.

ISO 39001:2012 mbi “Sistemi i menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor” e vlefshme, ose **ekuivalente**, ky certifikim shërben në lidhje me sistemet e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor, që është një çështje delikate dhe aktuale, me anë të së cilës garantohej mundësitë e menaxhimit të sigurisë në trafikun rrugor të një subjekti me synim parandalimin e aksidenteve dhe trafikun në rrugë, në respektimin e legjislacionit vendas në lidhje me sinjalistikën rrugore. Gjithashtu, ky certifikim fokusohet në njohjen e të gjitha aspekteve në menaxhimin e sigurisë të trafikut rrugor, duke bërë të mundur të përmirësohet ndikimi i veprimtarisë së përgjithshme të subjektit në këtë aspekt. Standardi ndërkombëtar ISO 39001 është zhvilluar me qëllim për të ndihmuar në përmirësimin e sigurisë në trafikun rrugor. Ai cakton rregullat për një sistem menaxhimi i cili mund të implementohet nga cdo shoqëri e cila ndërton, projekton, administron apo përdor infrastrukturën rrugore. ISO 39001 është zhvilluar me pjesëmarrjen e disa organizatave ndërkombëtare si Organizata Botërore e Shëndetësisë, Banka Botërore apo Federata Ndërkombëtare e Rrugëve.

2.4.2. Operatori ekonomik pjesëmarrës duhet të jetë i pajisur me licensë lëshuar nga QKL “Për grumbullim dhe transportim të mbetjeve të ngurta “Kodi III.2.B” (Për grumbullim dhe transportin e mbetjeve të ngurta), së bashku me aktin e miratimit, ose marrëveshje e vlefshme bashkëpunimi me operator të licensuar.

Argumentimi : Kërkesa e mësipërme është përcaktuar bazuar në nenin 39, pika 6/a, të VKM nr. 285 datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, të ndryshuar, si dhe në nenin 4, pika e 1/b e ligjit nr. 10448, datë 14.7.2011 “Për lejet e mjedisit” i ndryshuar, ku parashikohet se : “leja e mjedisit e tipit B është e detyrueshme për kryerjen e veprimtarive të kategorisë B, lista dhe pragjet përkatëse të të cilave janë përcaktuar në shtojcën 1/B të këtij ligji”.

Në shtojcën 1/B është listuar edhe veprimtaria “Menaxhimi i mbetjeve”.

Në nenin 57/2 të ligjit nr. 10463 datë 22.9.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”, i ndryshuar, parashikohet se : “Qendra Kombëtare e Licencimit lëshon licencën **për transportin e mbetjeve**, e cila përfshihet në nënkategorinë III.2.B të fushës III të vendimit nr. 538 datë 26.5.2009 të Këshillit të Ministrave “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga/apo nëpërmjet Qendrës Kombëtare të Licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta”, pas miratimit të saj nga ministri”.

Ndërkohë, sipas VKM nr. 538 datë 26.5.2009 “Për licencat dhe lejet që trajtohen nga apo nëpërmjet qendrës kombëtare të licencimit (QKL) dhe disa rregullime të tjera nënligjore të përbashkëta” : “Veprimtaria e nënkategorisë III.2.B specifikohet në veprimtari të tilla si grumbullim, transportim, riciklim, përpunim apo asgjësim i mbetjeve të llojeve të ndryshme”.

Argumentimi i specifikimeve teknike :

Specifikimet teknike janë hartuar nga specialistët e fushës, bashkëngjitur DST në SPE.

Të gjitha dokumentet duhet të jenë origjinale ose kopje të noterizuara.

Rastet e mosparaqitjes së një dokumenti, ose dokumente me të dhëna të rreme ose të pasakta, konsiderohen kushte për skualifikim.